



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr _____ prot

Tiranë, më _____ 2020

Lënda: *Kërkese për rishikim të Kushtetutës së Shqipërisë.*

Në mbështetje të nenit 177 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë pika 1, Ne Deputetët e poshtë shënuar kërkojmë rishikimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht neni 64 dhe 68 të saj.

Duke qene në dijeni të përmbajtjes së nenit 177 pika 2 e Kushtetutës së Shqipërisë, kërkojmë që kjo nisme e paraqitur prej nesh të fillohet të shqyrtohet të nesermen e ditës së mbarimit të gjendjes së fatkeqësisë të vendosur me Vendimin nr18/2020 të Kuvendit të Shqipërisë i cili ka dhënë pelqimin për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore deri më datë 23.06.2020.

Duke ju falenderuar,

Deputetët

Basë kërkuar lista e deputeteve firmëbore
Numri i deputeteve është 28

Edmond Jashari
[Signature]

Atmosfera bën 28
Pisuna deputetëve
Për përcaktimin e mandatit
do të miratohet për datën 23.06.2020
në zbatim të A.177 p.1 (2)
16.06



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ
Nr. ____/2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8417, DATË 21.10.1998, “KUSHTETUTA E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 83, pika 1, dhe 177, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e më shumë se një të pestës së anëtarëve të Kuvendit,

**KUVENDI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 64 ndryshohet si vijon:

- “1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhesh proporcional me konkurrin rajonal.
2. Numri i mandateve të deputetëve që i takojnë çdo rajoni zgjedhor përcaktohet në bazë të numrit të popullsisë së regjistruar në regjistrat shtetërorë. Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë partitë që në rang vendi kanë fituar jo më pak se pesë për qind të votave të vlefshme.
3. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore dhe për numrin e mandateve për secilën zonë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore, sipas përcaktimeve të ligjit për zgjedhjet.”

Neni 2

Paragrafi 1 i nenit 68 ndryshohet si vijon:

- “1. Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike dhe nga zgjedhësit. Nuk lejohen koalicionet parazgjedhore. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8417, DATË 21.10.1998, "KUSHTETUTA E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Amendamentet e propozuara, synojnë shndërrimin e sistemit zgjedhor nga ai aktual që bazohet në sistemin proporcional me konkurrim rajonal me lista të mbyllura në një sistem i cili në vlerësimin e propozuesve, referon më mirë dhe në format më demokratik vullnetin e votuesit. Për këtë qëllim amendamentet parashikojnë që detajimi aktual Kushtetues i konkurrimin rajonal me lista të mbyllura të hiqet nga Kushtetuta. Ai detajim sanksiononte lista të mbyllura dhe shprehja që formatonte sistemin u vendos në Kushtetutë megjithëse nuk e kish vendin aty, por sepse qëllimisht palët donin të mbyllnin me forcën e Kushtetutës çdo diskutim lidhur me listat e hapura.

Sistemi i propozuar është ai proporcional me konkurrim rajonal.

Kodi zgjedhor do të duhet që të bëjë më pas detajimin e sistemit të propozuar dhe identifikimin e sistemit për sa i takon listave të cilat duhet të jenë të hapura ose pjesërisht të hapura. Që kjo të ndodhë duhet që Kushtetuta ti paraprijë ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, nëpërmjet garantimit për votuesit të të drejtës për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumëmemërore.

Në vlerësimin e propozuesve, kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, duhet të parashikojnë atë pjesë të listës që do të jetë e hapur.

Në vlerësimin e propozuesve:

- sistemet me listat e hapura fuqizojnë votuesit duke i lejuar ata të zgjedhin kandidatët individualë të partisë sipas zgjedhjes së tyre duke votuar direkt për ta sesa për lista partiake të kandidatëve në tërësi;
- fuqizimi i votuesit mund të zvogëlojë fuqinë e drejtuesve të partive për të imponuar kandidatët e paracaktuar në elektorat. Efekti i dëshiruar është që kandidatët të jenë më shumë të përgjegjshëm ndaj votuesit dhe më pak para drejtuesit të partisë;
- Krahasimi midis sistemeve elektorale tregon një marrëdhënie pozitive midis listës së hapur dhe qeverisjes së mirë (antikorrupsionit).
- Vendet më të zhvilluara demokratike kanë sisteme me lista të hapura ku votuesit mund të përzgjedhin kandidatët (Islanda, Letonia, Monako, Norvegjia dhe Zvicra); vendet me një sistem të hapur përzgjedhje d.m.th. ku votuesit mund të përziejnë kandidatët nga listat e partive të ndryshme (Lihtenshtajni, Luksemburgu, Monako dhe Zvicra) dhe vendet që përdorin sistemin me vota të vetme të transferueshme (Irlandë dhe Maltë);
- Listat e hapura do të favorizojnë kandidatët më të kualifikuar duke qenë se përzgjedhja e tyre do të varet nga elektorati;

















- Listat e hapura favorizojnë programin e kandidatit dhe fushatën e këtij të fundit dhe që janë më të angazhuar me zonën dhe elektoratin ku do të kandidojnë


Amendamentet parashikojnë pragun 5% të votave të vlefshme, si kusht për përfshirjen në shpërndarjen e mandateve për partitë që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe edhe për shkak të modelit të sistemit të propozuar Kushtetuta duhet të parashikojë ndalimin e koalicioneve parazgjedhore.















Në tabelën e më poshtme evidentohet lidhja midis listave të hapura dhe qeverisjes demokratike të bazuar në raportet e Freedom House

Country	Freedom House Rating 2008	Transparency International Corruption Perceptions Index 2008 Rank	Transparency International Score	Electoral system 2008
Albania	Partly Free	85	3.4	Mixed
Armenia	Partly Free	109	2.9	Mixed
Azerbaijan	Not Free	158	1.9	SMD
Belarus	Not Free	151	2	SMD
Bosnia & Herzegovina	Partly Free	92	3.2	PR
Bulgaria	Free	72	3.6	PR
Croatia	Free	62	4.4	PR
Czech Republic	Free	45	5.2	PR (open lists)
Estonia	Free	27	6.6	PR (open lists)
Georgia	Partly Free	67	3.9	Mixed
Hungary	Free	47	5.1	Mixed
Kazakhstan	Not Free	145	2.2	PR
Kyrgyzstan	Partly Free	166	1.8	PR
Latvia	Free	52	5	PR (open lists)
Lithuania	Free	58	4.6	Mixed
Macedonia	Partly Free	72	3.6	PR
Moldova	Partly Free	109	2.9	PR
Montenegro	Partly Free	85	3.4	PR
Poland	Free	58	4.6	PR (open lists)
Romania	Free	70	3.8	PR
Russia	Not Free	147	2.1	PR
Serbia	Free	85	3.4	PR
Slovakia	Free	52	5	PR (open lists)
Slovenia	Free	26	6.7	PR (open lists)
Tajikistan	Not Free	151	2	Mixed
Turkmenistan	Not Free	166	1.8	SMD
Ukraine	Free	134	2.5	PR
Uzbekistan	Not Free	166	1.8	SMD


DEPUTETËT PROPOZUES

1. Edmond Starlec 
2. Nimez Musaj 
3. Myshkim Murrta 
4. Ergon Bojoshitri 
5. Klajdi Qaria 
6. Kexy Tokir 
7. Ramazan Gjuzer 
8. ~~Kristy Ipe~~  - rënhepar ^{shprehur} me deklarimet medietike
9. Lincor Rryci 
10. Hajlinda Halilaj 
11. Edmond Bursli 
12. ENADA KAPLLANI 
13. Arlind Çaçani 
14. Selami Jenishevi 
15. Hait Volturi 
16. ERVIS MËCO 

shprehur
prurën me
deklarimet medietike
Edmond Starlec


17. ENHER ROSHI 
18. Ediola Brahoi 
19. Yllio SHEHU 
20. Arben Elezi 
21. Aurora Mera 
22. Edlira Hyseni 
23. Vendi Stenovska 
24. Ushëri Shkëlqim 
25. HACIL YAKINI 
26. Vefër Koka 
27. Reme Kola 
28. Anoli Pismeti 
29. Eleua Xheq 
30. Arlind Çaçani 

Shënim: Numri i përgjithshëm i deputetëve është 29 (nëzet e nëntë) pasi është firmosur 2 (dy) herë nga deputeti Arlind Çaçani.


Gjergj Stojan